



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA SOLEMNE E KUVENDIT TË KOSOVËS ME RASTIN E
NJËVJETORIT TË PAVARËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 17 SHKURT 2009**

**SA SVEĆANE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA POVODOM GODIŠNJICE
PROGLAŠENJA NEZAVISNOSTI REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 17.
FEBRUARA 2009. GODINE**

**SHKURT – FEBRUAR
2009**

E martë, 17 shkurt 2009, ora 11:00.
Drejtoi seancën, zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit.

KRYETARI I KUVENDIT JAKUP KRASNIQI:

Të nderuar deputetë,
Të nderuar mysafirë,
Zonja dhe zotërinj,
Të nderuar qytetarë,

Sot, me rastin e njëvjetorit të shpalljes së shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës, mbajmë një seancë solemne.

(Intonimi i Himnit të Republikës së Kosovës)

(Duartrokitje)

I nderuari President, zoti Fatmir Sejdiu,
I nderuar Kryeministër, zoti Hashim Thaçi,
I nderuar kryesues i Përfaqësishë Civile Ndërkombëtare, zoti Peter Feith,
Të nderuar ministra,
Të nderuar mysafirë,
Të nderuar përfaqësues diplomatikë,
Të nderuar deputetë dhe deputete,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, kudo që jeni,

Para një viti, në këtë sallë, ne përfaqësuesit e zgjedhur të popullit të Kosovës, me përgjegjësinë kombëtare dhe historike e shpallëm Pavarësinë e Kosovës. Sot mbushet një vit nga lindja e shtetit më të ri të Evropës, shtetit të popullit më të vjetër të saj.

Në rrethanat historike dhe politike të një viti më parë, pavarësia e Kosovës u shpall,

Sepse Kosova ishte aneksuar padrejtësisht dhe kundër vullnetit të saj, nga Serbia e ish-Jugosllavia;

Sepse populli i Kosovës ka vuajtur shumë dhe ka luftuar gjatë për lirinë e tij;

Sepse breza të tërë veprimtarësh të çështjes së lirisë ishin sakrifikuar për këtë ditë;

Sepse Kosova e kishte shprehur disa herë vullnetin e shumicës absolute të qytetarëve për pavarësi dhe sovranitet që nga luftërat çlirimtare të viteve 1912-1913, 1919-1924, në Konferencën e Bunjajt më 1944, në demonstratat e viteve 1968, 1981, 1989, në Referendumin e vitit 1991 dhe me Luftën çlirimtare të organizuar dhe udhëhequr nga UÇK dhe Shtabi i saj i Përgjithshëm;

Sepse pavarësia mbështetej në përbërjen etnike, në aktet politike, historike e kushtetuese-juridike të brendshme, mbështetej në vendimet, marrëveshjet e rezolutat ndërkombëtare

për Kosovën;

Sepse Jugosllavia ishte shembur përfundimisht, kurse regjimi i Millosheviqit pas suprimimit të autonomisë kishte ushtruar gjenocid në Kosovë;

Sepse Kosova historikisht kishte subjektivitetin e mëvetësishëm politik e kushtetues, territorial e ekonomik, administrativ e juridik në Jugosllavi dhe kishte entitetin nëntëvjeçar të pasluftës nën administrimin civil ndërkombëtar, sipas Rezolutës 1244 të KS të OKB;

Sepse shpallja e pavarësisë ishte në përputhje të plotë me Kartën e OKB-së, të Drejtën e kombeve për vetëvendosje dhe e koordinuar me bashkësinë ndërkombëtare, OKB-në, Grupin e Kontaktit, SHBA e Bashkimin Evropian, por edhe në harmoni me bisedimet me Serbinë në çështjet ku janë arritur pajtueshmëri të dyanshme;

Sepse kishin përfunduar bisedimet midis Kosovës dhe Serbisë, të ndërmjetësuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe Grupi i Kontaktit për zgjidhjen e statusit të Kosovës, duke rezultuar me dokumentin në pako të Marrëveshjes gjithëpërfshirëse për zgjidhjen e statusit të Kosovës, të propozuar nga i dërguari i SP të OKB, zoti Marti Ahtisaari;

Sepse ishin pjekur kushtet dhe ishin përmbushur standardet demokratike për këtë akt historik;

Sepse paraprakisht Kuvendi i Kosovës kishte miratuar Rezolutën për rikonfirmimin e vullnetit politik për pavarësi;

Sepse paqja duhej të vendosej përfundimisht në rajonin tonë, duke mbyllur një kapitull të errët të historisë dhe duke pamundësuar kthimin e së kaluarës në Kosovë;

Sepse më 17 shkurt kishte ardhur ora yll e vendosjes së drejtësisë në Kosovë dhe kjo orë i hapi rrugë njohjes ndërkombëtare të shtetit më të ri në botë.

Zonja dhe zotërinj,

Sot është dita e fillimit të numërimit të përvjetorëve të pavarësisë së Kosovës. Data e 17 Shkurtit shënon kurorëzimin e përpjekjeve shekullore për liri të popullit të Kosovës.

Sot është dita kur kujtojmë me pietet gjithë ata burra e gra të Kosovës që nëpër breza u bënë kurban në themelet e pavarësisë së saj. Ky popull që nuk u përkul asnjëherë gjatë historisë së tij të dhembshme përkulet sot para të rënëve të tij.

Populli i Kosovës ka nxjerrë nga gjiri i vet shumë heronj, që nuk i përkasin më vetëm atij, por gjithë njerëzimit, sepse luftuan dhe ranë për vlera universale të lirisë, demokracisë e humanizmit. Është i madh ai popull që nxjerr njerëz të mëdhenj si Adem Jashari luftëtar - vizionar për themelimin e shtetit modern të Kosovës. Kosova përbëhet nga ata që e bënë, duke rënë dëshmorë në themelet e shtetit dhe nga ne të tjerët që duhet ta çojnë në vend amanetin e tyre për bërjen e shtetit. Siç thotë një fjalë amerikane, i përkasim atdheut

ashtu siç i përkasim nënës.

Në këtë ditë dhe në përvjetorët e pambarim të pavarësisë, falënderimi i parë u shkon dëshmorëve, u shkon veprimtarëve të të gjithë brezave të Lëvizjes Kombëtare, i shkon popullit që rezistoi kundër robërisë.

Me këtë rast solemn u shprehim mirënjohjen e thellë dhe falënderimin e madh botës demokratike, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vendeve të Bashkimit Evropian, NATO-s dhe të gjithë miqve tanë të shtrenjtë anekënd globit që ndihmuan Kosovën në proceset e vështira e historike të çlirimit, të vendosjes së paqes dhe të ndërtimit të demokracisë e të rimëkëmbjes pas luftës shkatërruese.

Zonja dhe zotërinj,

Në këtë përvjetor të parë të shtetit tonë, ballëhapur mund të paraqesim të arriturat e mëdha të fillimepokës së Pavarësisë, si: miratimi i simboleve shtetërore dhe i Kushtetutës, miratimi i ligjeve të shtetësisë së Kosovës, formimi i institucioneve përkatëse kushtetuese të saj, njohja e Republikës nga 54 shtete - anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, promovimi i shtetit demokratik dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm ekonomik e shoqëror, përfaqësimi i të gjitha komuniteteve pakicë në institucionet e Kosovës, miratimi i të gjitha ligjeve nga provizionet e Pakos së presidentit Ahtisaari dhe proceset pajtuese e integruese brenda shoqërisë sonë, që e kanë bërë Kosovën vend të standardeve të larta të mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve dhe të drejtave e lirive themelore të njeriut në përgjithësi.

Konsolidimi i tri pushteteve në Kosovë, legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit të pavarur, ngritja e infrastrukturës ligjore dhe e rrjetit diplomatik, instalimi i qeverisjes së mirë e efektive, sistemi i mirëqenies sociale dhe përmirësimi i dukshëm i infrastrukturës rrugore e asaj të arsimit, ngritja e cilësisë së mësimdhënies e arritje të tjera - janë rezultate evidente dhe të pakontestueshme. Për këtë vit ne kemi miratuar një buxhet për 15 për qind më të lartë se ai vitit të kaluar. Ky buxhet do ta nxisë zhvillimin ekonomik dhe do ta përmirësojë mirëqenien sociale.

Zonja dhe zotërinj,

Republika e Kosovës ka vendosur marrëdhënie miqësore me shumë vende të botës. Ne jemi krenarë për miqësinë që kemi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Bashkimin Evropian, me Turqinë, Japoninë, Kanadanë e vende të tjera demokratike e të fuqishme. Të një rëndësie të veçantë për ne janë marrëdhëniet më fqinjët tanë, me të cilët dëshirojmë t'i thellojmë më tej në të gjitha fushat, si partnerë strategjikë, në dobi të interesave të ndërsjella, të miqësisë midis popujve dhe të bashkëpunimit e të paqes në rajon. Ne jemi në rrugën e përbashkët të procesit të integrimit evropian. Nga një vatrë potenciale e krizave të rrezikshme, Kosova e pavarur u kthye në një faktor paqeje e stabiliteti rajonal.

Nga të gjithë fqinjët tanë, vetëm Republika e Serbisë nuk e ka njohur shtetin e Kosovës dhe nuk ka denjuar të ketë marrëdhënie me të. Ne, megjithatë, vazhdojmë ta mbajmë dorën e zgjatur dhe e ftojmë Republikën e Serbisë që ta njohë realitetin e ri të Kosovës së

pavarur dhe të dy vendet të fillojnë menjëherë procesin e pajtimit historik dhe epokën e bashkëpunimit e të marrëdhënieve të mira, në dobi të të dy vendeve dhe popujve, në dobi të paqes e stabilitetit rajonal si dhe të integriteteve evropiane të Ballkanit Perëndimor.

Komuniteti serb në Kosovë dhe komuniteti shqiptar në Serbi duhet të jenë një arsye më shumë për marrëdhënie dhe bashkëpunim midis dy vendeve tona. Zgjidhja e çështjeve të mbetura midis dy vendeve duhet të vazhdojë me vullnetin e përbashkët dhe në frymën e miqësisë e me bisedime. Populli ynë thotë „Duaje fqinjin, por gardhin mos e prish”. Me Serbinë mund dhe duhet të bisedojmë, por jo duke u përzier në punët e brendshme të njëri-tjetrit, sepse jemi dy shtete sovranë. Kosova ka Kushtetutën e saj dhe nuk guxon ta shkelë për hatrin e askujt. Pavarësia e Kosovës është realitet i ligjshëm dhe i pakthyesëm.

Zonja dhe zotërinj,

Bilanci i të arriturave në ditëlindjen e Republikës është i kënaqshëm, por siç thotë një fjalë, vetëm i marri kënaqet me vetveten, e jeta jonë në disa fusha lë për të dëshiruar shumë, prandaj kemi para vetës rrugë të gjatë dhe të vështirë drejt mirëqenies sociale, drejt zhvillimit ekonomik e demokratik, forcimit të shtetit ligjor, luftës kundër varfërisë, drejt shtrirjes së pushtetit shtetëror e administrativ në gjithë territorin e vendit, drejt integritetit të komunitetit serb në shoqërinë e Kosovës, drejt luftës kundër krimit e korrupsionit dhe drejt prioritetit tonë strategjik të integriteteve euroatlantike.

Kosova ka potenciale të shumta zhvillimi e përparimi, por nuk i mungon as mbështetja e solidariteti ndërkombëtar. Prezenca ndërkombëtare, civile dhe ajo e sigurisë, angazhimi i miqve tanë të shumtë për forcimin e vendit tonë dhe Konferenca e donatorëve e vitit të kaluar, e konfirmojnë përkushtimin e bashkësisë ndërkombëtare për Kosovën dhe popullin e saj. Vendosija e misionit EULEX në Kosovë ka përparuar mirë dhe besojmë që shumë shpejt do të kompletohet potenciali i tij, për të ndihmuar gjithë qytetarët dhe institucionet demokratike të Kosovës.

Presim që Kosova shpejt të anëtarësohet në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore, por edhe në organizma të tjerë ndërkombëtarë, duke përfshirë edhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Kosova është vend stabil dhe i sigurt. Forcat e KFOR-it, të Policisë së Kosovës dhe asaj të EULEX-it kujdesen për paqen, sigurinë dhe rendin në Kosovë. Është në proces edhe formimi i Forcës së Sigurisë të Kosovës, e cila po ngrihet sipas standardeve të NATO-s.

Pavarësia ka krijuar dhe po krijon kushte të favorshme për investime të kapitalit të huaj në Kosovë, siç janë siguria e stabiliteti politik, infrastruktura ligjore e fizike, telekomunikimet dhe lehtësitë doganore e tatimore, sigurimi i një mjedisi të qëndrueshëm biznesi, të cilat bashkë me pasuritë e mëdha dhe potencialin rinor e fuqinë e lirë punëtore, do të tërheqin investime të huaja dhe do të mundësojnë zhvillim të shpejtë të Kosovës.

E ardhmja e Kosovës është e sigurt dhe përvjetorët e Pavarësisë do ta gjejnë gjithnjë e më të fortë, gjithnjë e më të përparuar.

Ju faleminderit për vëmendjen!

(Duartrokitje)

Të nderuar deputetë,
Të nderuar mysafirë,
Fjalën e ka Presidenti i Republikës së Kosovës, zoti Fatmir Sejdiu.

PRESIDENTI I KOSOVËS FATMIR SEJDIU:

I nderuari Kryetar i Parlamentit të Republikës së Kosovës, z. Jakup Krasniqi,
I nderuari Kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi,
I nderuari Përfaqësues Civil Ndërkombëtar, z. Feith,
I nderuar shef i EULEX-it, Ive de Kermabon
Të nderuar deputetë,
Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të shteteve mike në Kosovë,
Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Kam nderin e veçantë t'i drejtohem Parlamentit të Republikës së Kosovës, institucionit më të lartë të shtetit demokratik, dhe nga këtu edhe të gjithë qytetarëve të Kosovës, në ditën e shënimit të njëvjetorit të shpalljes së Pavarësisë!

Më 17 shkurt 2008, pikërisht një vit më parë, përfaqësuesit e popullit shpallën Pavarësinë e Kosovës. Ishte një vendim historik pas shumë pune, flijimi dhe përkushtimi të brezave të tërë.

17 shkurti mbylli faqen e rëndë dhe të vështirë të historisë sonë, e cila brenda mban shumë dhimbje njerëzore dhe shkatërrime, por edhe akte dhe vepra të mëdha sublimë dhe të paharrueshme. Aty gjenden edhe mijëra viktima që nuk janë të gjetur që nga qershori i vitit 1999.

Ne sot jemi krenarë për atë që bënë paraardhësit tanë dhe jemi me shumë fat se na takoi të jetojmë dhe të punojmë në Kosovën shtet të pavarur dhe sovran.

Para një viti u realizua projekti më i madh që kishin synim shumë breza, një projekt që sot simbolizohet edhe me emrat e dy heronjve të mëdhenj të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, lider shpirtëror dhe politik i pavarësisë dhe Adem Jasharin, hero i luftës çlirimtare për liri.

Procesi i gjatë dhe i vështirë negociator për zgjidhjen e statusit u mbyll me shpalljen e Pavarësisë nga Përfaqësuesit e popullit të Kosovës për t'u pasuar nga njohjet ndërkombëtare të shteteve më të fuqishme të botës, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian dhe vendet e tjera nga të gjitha anët e globit.

Kështu, qytetarët e Republikës së Kosovës ka një vit që morën përgjegjësitë dhe detyrimet sikur të gjithë popujt dhe shtetet e botës së lirë dhe demokratike.

Sot mund të pyesim nëse kemi bërë atë që është dashur, atë që është pritur nga qytetarët dhe atë që kanë dëshiruar miqtë e vendit tonë të dashur.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Një vit pas shpalljes shtet i pavarur dhe sovran, Kosova bëri hapa të kujdesshëm, por vitalë për ngritjen e institucioneve demokratike dhe dëshmimin e plotë se shteti ynë e

ndihmon fuqishëm paqen dhe stabilitetin në rajon. Duhet pranuar se Kosova gjatë një viti kaloi nëpër një periudhë të ndjeshme politike dhe shtetbërjeje.

Katër muaj pas Deklaratës së Pavarësisë, ne miratuam Kushtetutën, aktin më të lartë juridik që i vuri themelet e shtetit demokratik të Republikës së Kosovës. Kushtetuta përfshin rekomandimet e Presidentit Marti Ahtisari, që dolën mbas një procesi të gjatë dhe të vështirë negociator ndërkombëtar. Mbështetur në Kushtetutën që valorizon vlera dhe parime moderne civilizuese dhe juridike, janë miratuar dhe po miratohen ligjet për të vënë në funksionim të plotë dhe legal të gjitha institucionet që e bëjnë një shtet efikas dhe në shërbim të qytetarit të tij.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës është shenja e parë dhe e fundit e vendimeve për të tashmen dhe të ardhmen e vendit tonë.

Ne sot kemi simbolet e shtetit: flamurin dhe himnin. Ndërkohë, janë krijuar institucione vitale shtetërore si Forca e Sigurisë së Kosovës, Agjencia e Inteligjencisë e Kosovës dhe është në proces edhe krijimi i Gjykatës Kushtetuese. Puna e këtyre institucioneve garanton stabilitetin dhe sigurinë e duhur për qytetarët dhe të ardhmen e shtetit tonë.

Të nderuar deputetë,

Deri tani vendi ynë është njohur nga 54 shtete dhe tashmë të ngarkuarit me punë të Republikës së Kosovës janë vendosur në dhjetë shtete. Këto ditë është vendosur të happen edhe tetë ambasada të reja dhe 9 misione konsullore. Ne i falënderojmë të gjitha këto shtete dhe qeveritë e tyre, që morën vendimin e njohjes.

Në këto njohje vlerësojmë veçmas vendimet e shteteve fqinje, të Maqedonisë dhe Malit të Zi. Marrëdhëniet e mira e miqësore me të gjitha vendet, në radhë të parë me fqinjët tanë të parë: me Maqedoninë, Shqipërinë, Malin e Zi e Serbinë, dhe me vendet e rajonit e të Evropës, mbeten prioritet në politikën tonë të jashtme.

Kuadrati i njohjeve të fqinjve ende nuk është mbyllur, ngase Serbia jo që nuk pranon realitetin, por e lufton atë, duke vazhduar ndërhyrjen dhe tendencën për të na destabilizuar, sidomos në Veri të vendit tonë.

Mendësia e konfliktit dhe e urrejtjes ende zotëron në kokat dhe institucionet kryesore të Serbisë. Politika destabilizuese e Beogradit nuk ndihmon as serbët dhe as rajonin.

Politika e vendit tonë është politikë e paqes. Ne punojmë çdo ditë që Kosova të bëhet pjesë e proceseve integruuese euroatlantike, që është përcaktim yni i fuqishëm. Integrimi dhe bashkimi me Unionin Evropian dhe me NATO-n, mbetet synimi themelor për të ardhmen.

Arritjet tona janë të lidhura edhe me ndihmën e aleatëve dhe miqve tanë të shumtë. Me këtë rast i falënderojmë UNMIKU-n, të gjitha vendet që kishin administratorë dhe shërbyes civilë ndërkombëtarë në Kosovë, i cili po mbyll një kaptinë të suksesshme në Kosovë. Respekt të veçantë meriton KFOR-i, që vazhdon të jetë garantuesi themelor i sigurisë.

Gjithsesi, roli i SHBA-së dhe i BE-së ishin të rëndësishëm së jashtëzakonshme jo vetëm për të mbërritur 17 shkurtin 2008, por edhe në këtë vit të parë të jetës së shtetit të Kosovës.

Ne kemi mirëpritur vendosjen e pranisë ndërkombëtare - misionit të EULEX-it, udhëhequr nga UE-ja - që ka rol mbikëqyrës në fusha të sigurisë e të ligjit dhe respektojmë shtrirjen dhe punën e tij në tërë vendin. Duke punuar bashkërisht, besoj, do të realizojmë synimin e afrimit të vendit tonë me shtetet e BE-së dhe anëtarësimin në institucione dhe organizata ndërkombëtare.

Të dashur qytetarë,
Kosova ndryshoi në këtë vit duke pasur rezultate të dukshme në të gjitha fushat ekonomike, sociale e arsimore.
Qytetarët edhe liderët në Kosovë kanë dëshmuar se janë në gjendje të mos jetojnë me të kaluarën. Ata duan të punojnë për të ardhmen.
Kemi popullsinë më të re në Evropë, 52 për qind e saj janë nën moshën 27-vjeçare, dhe kjo na detyron ende më shumë të punojmë për të ardhmen, për më shumë zhvillim ekonomik, për hapje të vendeve të reja të punës.
Jam shumë i vetëdijshëm se ende ka shumë njerëz që nuk jetojnë mirë. Ka shumë njerëz që nuk kanë vende pune, të cilëve u duhet ndihma dhe kujdesi social. Shteti ynë duhet të ketë më shumë ndjeshmëri për këto kategori sociale.
Suksesi ynë është ngusht i lidhur me funksionimin e shtetit ligjor në të gjitha segmentet e tij.
Të gjithë duhet të punojmë më tepër, që Kosova të bëhet një vend i sigurt dhe joshës për investime. Krijimi i lehtësive ligjore për investitorët vendës dhe të huaj është një mundësi më e madhe për zhvillimin ekonomik. Krijimi i lehtësimeve për lëvizje të lirë të njerëzve dhe investime të bizneseve do të mundësonte një racionalizim më të madh të potencialeve humane dhe ekonomike në rajon.
Besimi që është shprehur në Konferencën Ndërkombëtare të Donatorëve, në të cilën Kosovës iu dhanë 1.4 miliardë euro, duhet të kthehet në investime dhe rezultate përkatëse, në mënyrë që ky besim të rritet dhe përkrahja të shtohet edhe më shumë.
Edhe me këtë rast, theksojmë se Kosova do të ketë kujdes të veçantë ndaj komuniteteve pakicë, duke i trajtuar të gjithë ata pa dallim në pajtim me standardet më të larta ndërkombëtare. Ne po punojmë për të siguruar kushte dhe mundësi të barabarta për të gjithë, pra edhe për komunitetin serb. Kosova është vend i të gjithë qytetarëve të barbartë, ku nuk tolerohet dominimi i askujt mbi askënd. Kjo na ndihmon të jemi të gjithë pjesë e ndërtimit të Kosovës si shtet demokratik i qytetarëve të barbartë.

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj
Duke ju përshëndetur dhe duke ju uruar edhe një herë në këtë Përvjetor, juve deputetë dhe qytetarë të Republikës së pavarur të Kosovës, ju ftoj të gjithëve të punojmë bashkarisht që vendin tonë të dashur - Republikën e Kosovës, ta bëjmë shtet prosperues dhe të zhvilluar, shtet me institucione stabile demokratike, të cilat punojnë për t'u siguruar mirëqenie të plotë të gjithë qytetarëve të vendit.
Qëllimi ynë na inkurajon të shikojmë me besim nga e ardhmja!

Zoti e bekoftë Republikën e Kosovën!
Zoti i bekoftë të gjithë miqtë e Kosovës!
Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit, President Sejdiu!
Fjalën e ka Kryeministri i Kosovës, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI:

I nderuar, Kryetar i Parlamentit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi,
I nderuar, President i Republikës së Kosovës, zoti Fatmir Sejdiu,
Të nderuar Kabinet qeveritar,
Ju përfaqësues të popullit të Kosovës,
I nderuari zoti Peter Feith,
Të nderuar të gjithë ju ambasadorë sot prezent këtu në këtë përvjetor të pavarësisë së Kosovës,
Të nderuar të gjithë ju mysafirë,
Popull i dashur i Kosovës,

Kam nderin dhe kënaqësinë që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës t'ju përshëndes!

Sot është ditë për të festuar së bashku, me ngrohtësi, gëzim dhe solidaritet. Pikërisht, dhjetë vite më parë ne udhëheqësit e Kosovës, në Konferencën ndërkombëtare në Rambuje, në kohën e mbijetesës bashkë me partnerët dhe miqtë ndërkombëtar bisedonim dhe vendosnim për të Liri të Kosovës. Kosova fitoi!

Kaluan nëntë vite tranzicion plotë sfida, por të suksesshme.

Sot, është përvjetori i parë i shtetit tonë krenar, të pavarur, sovran dhe të lirë.

Sot të gjithë kemi ditëlindje.

Sot, kujtojmë të kaluarën tonë, respektojmë të kaluarën tonë dhe marrim zotime për të ardhmen.

Sot shënojmë festën më të madhe dhe të rëndësishme të popullit të Kosovës - Festën e shtetit të pavarur, demokratik me shoqëri shumetnike.

Përfaqësues të popullit, ju falënderoj të gjithë juve!

Gjithashtu, kabinet qeveritar, të gjithë qytetarët e Kosovës, miqtë tanë ndërkombëtarë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian, NATO-n, gjithë mbështetësit e Kosovës për punën që keni bërë bashkë me ne, deri më tani dhe atë që do ta bëni në të ardhmen për ta bërë vendin tonë edhe më të përparuar, edhe më demokratik në ditët, muajt dhe vitet që do të vijnë.

Viti që lamë pas ishte vit i të arriturave dhe i krenarisë, viti i suksesit historik të vendit tonë.

Për një vit kompletuam ndërtimin dhe funksionalizimin e të gjitha Institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës.

Duke punuar së bashku, ne krijuam një ndjenjë të re të optimizmit; një ndjenjë të re të besimit; të fuqisë dhe të bashkimit; që nuk ka sfida së cilës qytetarët e Kosovës nuk mund t'ia dalin së bashku.

Ekonomia jonë brenda vitit të pavarësisë shënoi rritje ekonomike për 6%.

Përvjetorin e parë të pavarësisë, e shënojmë me më shumë vende të reja pune, me rrugë të reja anekënd Kosovës, me më shumë shkolla moderne të pajisura me kabinete informatike. U krijua ambient më i sigurt për biznesin kosovar, siguri edhe më madhe për investuesit ndërkombëtarë, u tregua më tepër kujdes shëndetësor, u arrit standard më i lartë për jetesë të qytetarëve të Kosovës.

Por, më shumë se këto të arritura është ndjenja jonë e re e qëllimit dhe e guximit tonë. Atë mund ta shihni në familje, punë, në rrugë e sheshe, njerëzit duke i ndihmuar dhe kuptuar edhe më shumë njëri-tjetrin. Duke besuar në njëri-tjetrin. Të përkushtuar edhe më shumë për të pasur sukses. Sot kemi guxim për të pasur sukses! Sot e dimë të ardhmen tonë.

Ne i kemi treguar botës që e kemi merituar pavarësinë tonë dhe dimë ta ndërtojmë atë dhe e gëzojmë vendin në mesin e shteteve që përfaqësojnë lirinë.

Bota e shteteve të lira e vëren dhe e përshëndet përkushtimin dhe zotimin e Kosovës ndaj parimeve të lirisë, demokracisë dhe të jetesës së lirë për të gjithë.

Kosova është atdhe i të gjithë qytetareve të saj, me mundësi të barabarta për të gjithë, me të drejta të afirmuara për minoritarët.

Kosova u njoh zyrtarisht nga 54 shtete të lira të cilat përfaqësojnë rreth 70% të GDP-së në botë.

Sot, Kosova ka diplomaci aktive anë e kënd botës. Gjatë muajve të ardhshëm presim të njohje të reja. Suksesi ynë në Kosovë nënkupton njohje të reja nga bota e suksese do të kemi të gjithë bashkërisht duke punuar.

Kosova do të njihet nga e gjithë bota. Kosova do të bëhet anëtare me të drejta të plota gjatë këtij viti në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore.

Vitin e kaluar ne pranuan Raportin e Progresit evropian për Kosovën, këtë vit do të kryhet studimi i fizibilitetit, jam i bindur me sukses tonin të të gjithëve që jemi këtu dhe të tjerëve.

Kosova ecën e sigurt për integrim në NATO, në Bashkim Evropian e në të ardhmen edhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Të nderuar përfaqësues të popullit,

Viti ynë i parë në pavarësi ishte vit i të arriturave dhe i krenarisë. Ishte viti i unitetit politik, qytetar dhe shtetëror të Kosovës. Çdo qytetar ka hise në pavarësinë e Kosovës, secili le të ndihet krenar me të arriturat e përbashkëta.

Sot, festohet në çdo familje, qytet, fshat e lagje kudo, edhe në diasporë. Festa e pavarësisë

së Kosovës tejkalon kufijtë e Republikës sonë. Të gjithë festojmë dhe punojmë që të gjejmë rrugën më të mirë për të çuar Kosovën përpara. Edhe pse mund të dallojmë në ide, të nderuar përfaqësues të popullit, qëllimin e kemi të përbashkët - ta ndërtojmë një Kosovë edhe më të mirë. Mund dhe kemi dallime në ide të ndryshme politike. I takojmë besimeve të ndryshme, apo i takojmë përkatësive të ndryshme etnike, por një gjë të gjithë e kemi të përbashkët: të gjithë jemi shtetas të Kosovës, të gjithë e duam Kosovën, prandaj le ta ndërtojmë bashkërisht.

Të nderuar përfaqësues të popullit,
Mysafirë, të nderuar,
Të dashur qytetarë të Kosovës,

Në këtë sallë u miratuan 61 ligje bashkë me 51 ligje të tjera që dalin nga plani i Presidentit Ahtisari për pavarësinë e Kosovës.

Më 15 qershor 2008, ne miratuam dokumentin më të rëndësishëm për Kosovën - Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kjo Kushtetutë moderne, e para e vullnetit politik të qytetarëve të Kosovës, është një e arritur për t'u mburrur. Ajo garanton liri, demokraci dhe qeverisje të mirë për të gjitha komunitetet në Kosovë.

Përkushtimi ynë për unitet qytetar në Kosovë ishte i sinqertë dhe i vazhdueshëm.

Çelësi i suksesit tone qëndron në unitet. Kosova do të vazhdojë të jetë e bashkuar si vend dhe popull.

Përveç Kushtetutës, ne krijuam simbole gjithëqytetare: flamurin e himnin, të cilat përfaqësojnë parimin e Kosovës shumetnike.

Në bashkëpunim me Zyrën Civile Ndërkombëtare, Qeveria po punon për të mbrojtur vendet e trashëgimisë kulturore, për të bërë reformimin e pushtetit lokal. Qeveria ka miratuar legjislacionin më të avancuar për të drejtat e komuniteteve, duke ndërtuar qendra kulturore, duke ndërtuar edhe rrjete ujësjellësish dhe duke përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë çdo ditë.

Jam krenar që pavarësia e Kosovës solli më shumë stabilitet në Kosovë, më shumë stabilitet në rajon, bashkëpunim rajonal dhe perspektivë evropiane. E ardhmja e Kosovës evropiane është e sigurt.

Të gjithë duan të ndërtojnë të ardhmen e tyre këtu, të gjitha komunitetet nën flamurin e ri të Kosovës.

Përfaqësues të popullit të Kosovës,
Kolegë të nderuar,
Kabinet qeveritar,
Mysafirë të nderuar,
I nderuar President i Kosovës,

Sot, bota po përballlet me sfida. Kriza globale ekonomike është ballafaqim real.

Megjithatë, ne po ecim përpara. Këtë mund ta shihni në rrugët tona të reja, ndërtesa të reja, banim më të mirë, më shumë kujdes për më të moshuarit tanë dhe mundësi më të mira për të rinjtë tanë. Ne po zbatojmë standarde të të arriturave të cilat vendi ynë nuk i ka pasur asnjëherë.

Ne po lëvizim sigurt drejt rezultateve më të mëdha dhe të ndjenjës së përbashkët për një të nesërme edhe më të mirë.

Ju përfaqësues të popullit, mysafirë të nderuar në këtë sallë, të gjithë ne kemi kontribuar për ta bërë të mundur këtë që kemi arritur. Por, sot nuk është dita për ta përgëzuar vetveten, por për t'i falënderuar qytetarët, sepse janë qytetarët ata që e bëjnë Kosovën edhe më të fortë, edhe më të bashkuar, edhe më të suksesshme. Edhe më me rëndësi, t'i përqafojmë njerëzit dhe t'i ushqejmë shpresat dhe ëndrrat e tyre. Zotimet t'i bëjmë realitet.

Shteti i Kosovës qëndron në zemrat e nënave që kujdesen për fëmijët e tyre, të dyqanxhinjve që hapin dyert e tyre çdo ditë dhe të bujqve që punojnë tokën në vendin tonë.

Janë shkëndijat rinore dhe urtësia e moshës të cilat i festojmë sot në përvjetorin tonë të parë. Populli i Kosovës ka bërë rrugë të gjatë për të arritur këtu ku jemi. Ka bërë rrugë të sakrificës. Kemi bërë rrugë të përbashkët në Rambuje me Presidentin Rugova. Sot kujtojmë respektin më të lartë edhe për babanë e pavarësisë së Kosovës, Adem Jasharin.

Sot, në Ditën e Pavarësisë, e ardhmja jonë kurrë nuk ka qenë më e ndritshme, liria kurrë s'ka qenë më e madhe dhe mundësitë kurrë nuk kanë qenë më të dukshme.

Të nderuar përfaqësues të popullit,
Ju nënshkrues të pavarësisë së Kosovë,
Qytetarë të dashur të Kosovës, ju më meritoret për shtetin tonë,

Dje unë vizitova fëmijën e parë që u lind në Kosovën e pavarur. Emri i saj është Pavarësi. Ishte e bukur dhe shëndetshme, po aq sa është i bukur dhe i shëndetshëm shteti ynë. Duke e shikuar këtë fëmijë, duke parë familjen e saj, në mendje më shkuan shumë mendime. Çka e preat këtë fëmijë në jetën e vet? Çfarë mundësish do të ketë? Ne të gjithë kemi sakrifikuar aq shumë për të dhe për të gjithë fëmijët e Kosovës. Ne u bëmë bashkë ashtu që ajo të mund të lindej në liri. Fëmijët e Kosovës do të rriten si të gjithë fëmijët e botës. Tani çfarë tjetër do të ndikojë në fatin e saj në jetë? Çfarë arsimi do të marrë? Çfarë mundësish për karrierë do t'i ofrohen?

Kur ajo të lind gjeneratën e dytë të Kosovës së lirë, ajo do të ketë kujdes shëndetësor të standardeve më të mira evropiane. Ajo do të mund të rrisë fëmijët e saj në një Kosovë të bukur, me parqe, me fushëloja dhe me rrugë edhe më të pastra në Kosovën tonë moderne. Ajo është ajo për të cilën ne punojmë. Kjo është arsyeja pse ne punojmë bashkë, çdo ditë, secili nga këndvështrimi i vet dhe të gjithë të fokusuar se si t'ia mundësojmë Pavarësisë së vogël, të gjithë fëmijëve tanë, Kosovën e shpresave, Kosovën e ëndrrave tona, Kosovën edhe më të fuqishme, edhe më të bukur, edhe më moderne, edhe më të zhvilluar.

Sot, të nderuar përfaqësues të popullit, Kosova feston. Nesër, të gjithë i kthehemi punës, për Pavarësinë, për veten tonë, për familjet tona, për Kosovën.

Urime përvjetori i pavarësisë Kosovë!

Urime dhe le të festojmë së bashku!

Ju faleminderit dhe gëzuar Dita e Pavarësisë!

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT:

Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,
Seancën e sotme solemne e nderon edhe prezenca e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, zotit Peter Feith, i cili do t'i drejtohet Kuvendit dhe qytetarëve të Kosovës me një fjalë rasti.

(Duartokitje)

PËRFAQËSUESI CIVIL NDËRKOMBËTAR PETER FEITH:

President Sejdiu,
Prime Minister Thaçi,
President of the Assembly Krasniqi,
Honorable Ministers,
Distinguished Members of the Kosovo Assembly,
Excellencies,
Ladies and Gentlemen,

It is a distinct honor to address you from the rostrum of the Assembly of Kosovo, the seat of the legislative branch of Kosovo's government.

This is the People's house, the rightful home for free speech and debate of all the political issues of the day, bearing in mind the broader national interest.

We gather here, in this legislature, to mark the first anniversary of Kosovo's independence.

This year just past has seen many historic dates, many momentous achievements.

One year ago today, 17 February 2008, with the ratification of its Declaration of Independence, Kosovo joined the family of nations, as an independent and sovereign state.

At the heart of your Declaration of Independence, you, the legitimately elected political leaders of Kosovo, pledged your full commitment to the implementation of the Ahtisaari Plan, the Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement (CSP).

This anniversary holds special meaning for you – and for me.

April 9, 2008 was another momentous day for your young state, as you took the principles that you expressed in your founding act – your desire for reconciliation, commitment to diversity, and devotion to democracy – and enshrined them in your highest law, the Constitution.

It was my honor to speak at that event as well.

Little more than two months later, 15 June, Kosovo's highest law came into force, and with it was promulgated a host of legislation called for by the CSP, including laws to build the institutions of the new state, and some of Europe's most advanced protections for the rights of communities and their members.

I walked this road with you.

I salute you for these efforts, and all the progress that has been made in the past year.

December 9 marked another significant day for the Republic - the deployment of EULEX, throughout the entire territory of Kosovo.

Their arrival turned a page in Kosovo's history.

May their work, in partnership with yours, strengthen the rule of law in this land, and bring you ever closer to your European future.

While today marks the end of Kosovo's first year of statehood, let it also mark a new beginning, a recommitment to pledges in the Declaration of Independence and the Constitution, to build a multi-ethnic democracy, "a home for all of Kosovo's citizens."

Mr. Speaker,

As Kosovo begins its second year as an independent state, let us continue our efforts, as partners, to make this year one of further achievements for stability, reconciliation and reform.

First of all, let us work for stability, based on the rule of law - the guarantee of safety and security for all of Kosovo's citizens. A country free from foreign interference.

Let us recommit, as the Declaration of Independence states, to address the past "in a spirit of reconciliation and forgiveness".

Let this spirit urge us on to value the richness of Kosovo's diversity of language, religion and cultural heritage, and to fully implement the laws that you have passed to safeguard them.

Finally, together, let us commit to thoroughgoing reform – the daily work of every democracy, with a view to establishing full transparency and accountability.

In the economy, I urge you to improve the social and economic conditions of the poor and the vulnerable. Privatization of key publicly owned enterprises will be a strong message about the seriousness of your European perspective.

As for reform of governance, my message is clear – let us work together to make the decentralization process a success, both through the creation of the new CSP municipalities and the devolution of additional governing authority to all municipalities.

This process, in the tradition of local government in Europe and America, will benefit all of Kosovo's communities and all of Kosovo's citizens.

Mr. Speaker,

To conclude, let me thank you for the privilege to address this chamber on such a special day. And let me express my best wishes to all the citizens of Kosovo through their elected representatives.

May your work in this Assembly, and our work together, contribute to the continued growth of the Republic of Kosovo, as a multi-ethnic, democratic state, free, prosperous and at peace.

Urime ditëlindjen e Republikës!

(Duartrokitje)

Srećan rojendan!

Happy Birthday! Congratulations to all!

Faleminderit, shumë!

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT:

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Falënderojmë Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar për fjalën e tij përmbajtjesore dhe me këtë përfundon seanca solemne.

Urime festa e pavarësisë!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve